

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Evropa shqyrton plane emergjente pas provokimeve ruse dhe paralajmërimeve për sulm të mundshëm
ADRESA	https://dosja.al/bota/evropa-shqyrton-plane-emergjente-pas-provokimeve-ruse-dhe-paralajmerimeve-p-i515743
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 06:30:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 06:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	edec7cce10296d95a59adaf57f405ae6d75725e2bc9d90a012b959fbab59b2cd
TEKSTI	4c79b7e4e2cdebecd5bf711b4ef6dd7e592f87cddb11e6d3c0751b478202e3e7
PAMJA	fbfd238152e06013717036d781c80522ff3c21d2f7f43314ffb4c05ee1c7ae64

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c901b652305583bbb4d2d4c705c6030469d9b2859a9cbc2132e05f44b2f71b53
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	87b4361ed98fb15f0deeff084a0155e0f52bdbc102547d1a16b6b1abc08a3633
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c901b652305583bbb4d2d4c705c6030469d9b2859a9cbc2132e05f44b2f71b53>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

9 ORE ME PARE

EMRAT/ Plagosje me thikë në Tiranë, humb jetën 49-vjeçari, arrestohet autori

13 ORE ME PARE

Dita e 116-të e protestës/ Qytetarët zbesin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

17 ORE ME PARE

"Kërkojmë dorëheqjen urgjente të Ramës"/ Berisha: Këto janë kulme të një shteti i cili po zë shqiptarët brenda! Fjalën tani duhet ta marrin qytetarët

17 ORE ME PARE

"Do të përfundojmë keq o shpirt"/ Zbardhen bisedat, Viora Hyseni i raportonte Ergys Agasit axhendën dhe takimet me Ramën: Ika se do takoj KM

Bota

Evropa shqyrton plane emergjente pas provokimeve ruse dhe paralajmërimeve për sulm të mundshëm

Moska mohon vazhdimisht çdo përfshirje në operacionet e sabotimit që qeveritë evropiane ia atribuojnë asaj, por zyrtarët në kryeqytetet e NATO-s dhe BE-së kanë shtuar përpjekjet për të hartuar plane emergjente dhe masa kundërvepruese.



24 Shtator 2026, 08:21
Nga G.M



Trupat e NATO-s gjatë një stërvitjeje ushtarake pranë kufirit të Polonisë me Lituaninë. Fotografi nga arkivi.

Presidenti i Letonisë, Edgars Rinkevics, nuk pajtohet me thirrjet e vazhdueshme dhe raportimet se Rusia mund ta sulmojë NATO-n ose Bashkimin Evropian në muajt e ardhshëm, në përpjekje për ta dobësuar mbështetjen e tyre për Ukrainën. Ai thotë se kjo tashmë ka filluar.

"Ne nuk po flasim për një luftë konvencionale. Po flasim për të gjitha llojet e provokimeve, të gjitha llojet e akteve të sabotimit, të gjitha llojet e testimeve dhe, padyshim, kjo është diçka që po ndodh derisa ne po flasim", tha lideri leton për Radion Evropa e Lirë (REL) në një intervistë të zhvilluar në selinë e Kombeve të Bashkuara më 21 shtator.

Zyrtarë të inteligjencës evropiane, CIA, madje edhe presidenti francez Emmanuel Macron dhe kryeministri polak Donald Tusk, kanë paralajmëruar ditët e fundit se Moska mund të shkojë aq larg sa që të kryejë ndonjë sulm ajror, në një formë apo tjetër, ndaj territorit të NATO-s në muajt e ardhshëm, për të treguar se zotimi i aleancës ushtarake për mbrojtje të përbashkët, sipas Nenit 5, është pak a shumë disa fjalë në një copë letre.

Rastet e sulmeve të muajve të fundit, që i janë atribuuar Rusisë dhe që Instituti për Studimin e Luftës (ISÉ) i quan "seri e koordinuar fushatash kinetike" përfshijnë zjarrvënien, plane për atentate dhe sabotim të infrastrukturës, si dëmtimi i hekurudhave dhe ndërhyrjet elektronike.

Moska mohon vazhdimisht çdo përfshirje në operacionet e sabotimit që qeveritë evropiane ia atribuojnë asaj, por zyrtarët në kryeqytetet e NATO-s dhe BE-së kanë shtuar përpjekjet për të hartuar plane emergjente dhe masa kundërvepruese.

Skenari i Narvës

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

BOTA 24 SHTATOR 2026, 08:00

"Si kositëse bari fluturuese"/ Dronët e Amazonit shqetësojnë banorët në Teksas, ndryshon lartësia e fluturimeve

ART&ARGËTIM 24 SHTATOR 2026, 07:56

"Nuk kemi pasur bisedë"/ Stallone refuzon rolin e të dërguarit të Trumpit për Hollywoodin: E mësova nga televizori

Një skenar i tillë është i ashtuquajtur "skenari i Narvës", i cili përshkruan një situatë hipotetike ushtarake në të cilën Rusia do të sulmonte një vend të NATO-s duke përdorur taktika të luftës hibride, të ngjashme me fazën fillestare të pushtimit të vërtetë të Krimesë nga Rusia në vitin 2014.

Narva është një qytet i vogël me një popullsi të madhe ruse në anën estoneze të kufirit me Rusinë. Analistët kanë thënë se një veprim i tillë nga Rusia mund të shihet si një mënyrë për ta testuar gatishmërinë e NATO-s për të rrezikuar një përballje të drejtpërdrejtë për një territor me rëndësi të kufizuar strategjike.

Ministri i Jashtëm i Estonisë, Margus Tsahkna, paralajmëroi për rritjen e sulmeve hibride ruse në gjithë Evropën, në një intervistë për REL-in këtë javë, duke thënë se ka shumë zëra se Putini do ta kryejë një operacion ushtarak në shkallë të plotë kundër shteteve baltike ose Polonisë. Por, shtoi ai, "inteligjenca jonë nuk sheh ndonjë lëvizje serioze ushtarake në anën tjetër të kufijve tanë, sepse Rusia është e bllokuar në Ukrainë".

Analistët e ISÉ-së, megjithatë, thanë më 21 shtator se, ndonëse Estonia dhe Letonia kanë deklaruar se ende nuk kanë vërejtur ndonjë dëshmi për grumbullimin e forcave ruse pranë kufijve të tyre, që do të ishte i nevojshëm për një pushtim në shkallë të plotë të vendeve të tyre, "skenarët për veprimet e Rusisë nuk u janë nënshtruar analizës së hollësishme që meritojnë dhe kërkojnë".

REL-i kontaktoi disa diplomatë që kanë njohuri për planifikimin e gatishmërisë së BE-së dhe NATO-s, por asnjëri nuk pranoi të jepte shembuj konkretë të asaj që po përgatitet, duke thënë se informacioni është i klasifikuar. Një zyrtar nga Evropa Qendrore pranoi se në nivel pune zhvillohen diskutime joformale lidhur me atë se çfarë duhet bërë nga pikëpamja logjistike në rast se shtetet baltike dhe Polonia sulmohen, por shtoi se nuk ka udhëzime zyrtare dhe përgatitje konkrete në terren.

Një zyrtar i NATO-s tha se aleanca ka planet kombëtare të mbrojtjes së vendeve anëtare, "të cilat janë tepër sekrete, por në thelb përcaktojnë se çfarë bëjmë në të gjitha llojet e skenarëve të luftës". Rinkevics tha se cilësimi i valës së tanishme të sulmeve ruse si "hibride" mund të jetë gjithashtu duke zbehur urgjencën e nevojshme mes zyrtarëve evropianë për ta trajtuar këtë situatë.

"Mendoj se kur përdorim fjalën 'hibride', atëherë disi tingëllon, le të themi, më pak e rrezikshme, një terminologji disi më e pafajshme sesa janë në të vërtetë vetë këto akte", tha ai.

"Mendoj se skenari më i rrezikshëm do të ishte nëse Rusia bëhet e pamatur, nëse ne nuk reagojmë në mënyrë efikase dhe ka viktimë të vërteta... Pjesa jonë e Evropës po përpaket të jetë sa më e gatshme që të jetë e mundur. Por shikoni, nëse Rusia nis sulm me raketa, atëherë është absolutisht e qartë se ky është Neni 5 dhe atëherë është absolutisht e qartë se do të ketë një reagim", shtoi ai.

Një bazë e përhershme amerikane në Poloni?

Tensionet e rritura kanë tërhequr vëmendjen e Uashingtonit, i cili ka shqyrtuar vendosjen e trupave amerikane në Evropë, marrëveshjet për bazat ushtarake, marrëveshjet për statusin e forcave dhe negociatat e përgjithshme me vendet pritëse. Javën e kaluar, presidenti amerikan Donald Trump tha se Uashingtoni dhe Varshava po bëjnë "përparim të madh" drejt krijimit të një baze të përhershme të ushtrisë amerikane në Poloni, gjë që potencialisht do ta zgjeronte praninë ushtarake amerikane në krahun lindor të NATO-s.

Ky zhvillim erdhi një ditë pasi autoritetet polake mbyllën përkohësisht aeroportet në Lublin dhe Rzeszov, kur sulmet ruse goditën pjesë të Ukrainës pranë kufirit me Poloninë, sipas zyrtarëve polakë. Kryeministri polak, Donald Tusk, ka paralajmëruar gjithashtu se Rusia mund të përpaket të kryejë sulme me dronë ose raketa ndaj vendeve të NATO-s që mbështesin Ukrainën, duke i paraqitur ato si aksidente.

Edhe ai tha se incidente të tilla mund të synojnë të testojnë reagimin e NATO-s dhe të minojnë unitetin e aleatëve. Sipas Tuskut, vlerësimi bazohej në informacione nga NATO-ja, Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara. Në mënyrë të ngjashme, shtetet baltike u alarmuan vitin e kaluar kur tre avionë luftarakë rusë shkelën hapësirën ajrore të Estonisë për 12 minuta.

Në pragu e NATO-s: Pikat kufitare që po goditen përgjatë kufijve të Ukrainës

Rusia pretendoi se kishte shënjestruar "objekte logjistike" në pikën kufitare, të cilat përdoreshin për "dërgimin e ngarkesave ushtarake në territorin e Ukrainës". Kryeministri polak, Donald Tusk, paralajmëroi më 13 shtator se "javët dhe muajt e ardhshëm do të jenë një periudhë e veprimeve shumë intensive nga pala ruse". Ai shtoi se të dhënat e inteligjencës sugjerojnë se Moska do të "përpaket të pengojë, paralizojë dhe ndoshta edhe të shkatërrojë pikat kufitare të Ukrainës".

Sipas zyrtarëve estonezë, pilotët rusë e pranuan, por e shpërfillën komunikimin nga dy pilotë italianë me avionë luftarakë F-35, të cilët ishin ngritur në ajër nga Misioni i NATO-s për Policimin Ajror në Baltik, në bazën ajrore Amari në Estoni, para se përfundimisht t'i shoqëronin avionët rusë drejt hapësirës ajrore ndërkombëtare. Tsahkna theksoi në intervistën e tij për REL-in se Rusia tashmë po sulmon Evropën. Në përgjigje të inkursionit, të cilin Rusia e mohon, Estonia bëri thirrje për konsultime sipas Nenit 4 të NATO-s, të cilat janë një hap para aktivizimit të

ART&ARGËTËM 24 SHTATOR 2026, 07:51

'Husband for an hour'? Burrat mungojnë në Letoni, shifra prej 3 mijë dollarësh për 'qira' mbetet e pakonfirmuar

më të klikuarat

Bomba tjetër për qeverinë Rama/ Prova e fakte se ku shkojnë paratë e zhvatura nga korrupsioni

"Nuk kam mbajtur marrëdhënie personale"/ Vlorë Hyseni nxjerr bllof Ramën në bisedat me Agasin: Ika se do takoj KM

"Kështu janë infot...Tao shoku"/ Ish-kreu i SHISH fliste me Agasin dhe për politikë: Balla, kryetar Kuvendi

Prokuroria e Posaçme zbuloi 9 faqe me të dhëna sekrete të SHISH në makinën e Agasit, biznesmeni: I lash me qëllim që t'i gjente SPAK

insights

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by  tomorrow

"Ne duhet të jemi të gatshëm të veprojmë të bashkuar", tha Tsahkna.

Presidenti rus, Vladimir Putin, nuk po jep asnjë shenjë se "vërtet do të donte të kishte një paqe kuptimplotë dhe një paqe të drejtë e të qëndrueshme" me Ukrainën, pas më shumë se pesë vjetësh luftë, dhe po vëzhgon mënyrën se si reagon Evropa ndaj provokimeve.

"Por nëse ai do ta ketë Ukrainën, ky është vetëm një hap dhe do të shohim agresion të mëtejshëm në Evropë", paralajmëroi ministri estonez./REL

edgars rinkevics
 letoni
 rel

Sondazh

Poll

Bota

24 Shtator 2026, 08:05

Takimi me presidentin Trump në Uashington/ Xi Jinping: Kina dhe SHBA duhet të jenë partnerë, jo rivalë

Xi Jinping SHBA- Presidenti kinez Xi Jinping ka bërë thirrje për një marrëdhënie më të qëndrueshme mes Kin&eu...

"Si kositëse bari fluturuese"/ Dronët e Amazonit shqetësojnë banorët në Teksas, ndryshon lartësia e fluturimeve

Bota

24 Shtator 2026, 08:00

Macron në OKB/ Paralajmërim për rikthimin e imperializmit dhe forcës pa rregulla: Kam frikë se nuk do të jem origjinal

Bota

24 Shtator 2026, 07:38

Bojkotimi i mediave ne SHBA/ Gjykata urdhëron Trumpin të rikthejë CNN, MS NOW dhe Politico në Shtëpinë e Bardhë

Bota

24 Shtator 2026, 07:33

Kriza e Ebolas në Kongo/ SHBA-të akordojnë 267 milionë dollarë shtesë për përballimin e epidemisë

Bota

24 Shtator 2026, 07:28

Bota

24 Shtator 2026, 07:21

Misioni 286 ditor i anijes luftarake USS Abraham Lincoln, regjistroheshin tetë raste vetëvrasjesh

Anija USS Abraham Lincoln SHBA- Tetë raste të tentativave për vetëvrasje janë raportuar gjatë dislokimit 286-ditor të ae...

Marrëdhëniet SHBA-Turqi përballen me çështje të nxehta, Erdogan merr komplimentet e Trumpit por jo avionët F-35

Bota

24 Shtator 2026, 07:10

SIPA dhe EUROPOL-i në aksion kundër kontrabandës së armëve, i dyshuari qëllon veten në kokë

Bota

23 Shtator 2026, 22:20

VIDEO/ Mesazhi i Netanyahut para fjalimit të tij në OKB: Do t'i përgjigjem gënjeshtreve kundër Izraelit, do të ketë surpriza

Bota

23 Shtator 2026, 21:16

Konflikti me Rusinë/ Zelensky në OKB:
Sa më shumë liri veprimi të ketë Putin, aq
më i rrezikshme bëhet...

Beta

23 Shtator 2026, 20:53

MË SHUMË

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.